


# ÇFARË NDODH PAS DIPLOMIMIT NGA SHKOLLA

Rezultatet nga  
gjurmimi i të  
diplomuarve  
2018-2022



Ky raport është hartuar nga Jonida Jani nën kujdesin e Aleka Papa, Projekti “Aftësi për Punë” (S4J).  
Koordinator për gjurmimin në Shkollën Teknike Ekonomike Tiranë: Jonida Nano

### **Rreth projektit “Aftësi për Punë” S4J**

“Aftësi për Punë” S4J është një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), i cili zbatohet në Shqipëri nga organizata Swisscontact. S4J adreson sfidat kryesore në Arsimin dhe Formimin Profesional (AFP) në Shqipëri duke investuar për sigurimin e ndryshimeve sistematike, zhvillimin e kompetencave dhe fuqizimin e aktorëve. S4J mbështet ofruesit partnerë të AFP-së në drejtim të krijimit të lidhjeve të ngushta me kompanitë e sektorit privat dhe partnerë të tjerë, diversifikimit dhe përmirësimit të ofertës mësimore, aplikimit të metodave të reja të mësimdhënies dhe standardeve të cilësisë, realizimit të praktikave mësimore në mjediset e biznesit dhe zhvillimit e fuqizimit të institucionit.

## Lista e figurave

Figura 1: Shpërndarja sipas gjinisë (2022) .....	7
Figura 2: Shpërndarja sipas drejtimeve (2022) .....	7
Figura 3: Vendbanimi i të diplomuarve (2020-2022) .....	7
Figura 4: Përfshirja në tregun e punës një vit pas diplomimit (2022) .....	8
Figura 5: Përfshirja në tregun e punës një vit pas diplomimit (2018-2022) .....	9
Figura 6: Punësimi përkundrejt vetë-punësimit (2018-2022) .....	10
Figura 7: Statusi i punësimit një vit pas diplomimit sipas drejtimeve (2022) .....	10
Figura 8: Statusi i punësimit një vit pas diplomimit sipas gjinisë (2022) .....	11
Figura 9: Lidhja e punës me fushën e arsimit (2018-2022) .....	11
Figura 10: Lidhja e punës me fushën e arsimit sipas drejtimit (2020-2022) .....	12
Figura 11: Lidhja e punës me arsimin sipas gjinisë (2022) .....	12
Figura 12: Niveli i pagave një vit pas diplomimit (net) 2022 .....	14
Figura 13: Niveli i pagave një vit pas diplomimit (net)(2018-2022) .....	15
Figura 14: Niveli i pagave sipas drejtimit (2022) .....	15
Figura 15: Niveli i pagave sipas gjinisë (2022) .....	16
Figura 16: Punësimi me kohë të plotë përkundrejt punësimit me kohë të pjeshme (2018-2022) ...	16
Figura 17: Madhësia e kompanisë (2018-2022) .....	17
Figura 18: Lloji i kontratës (2018-2022) .....	18
Figura 19: Ndërgjegjësimi rreth pagesës së sigurimeve nga punëdhënësi (2018-2022) .....	18
Figura 20: Periudha kohore në kërkim të një pune (të diplomuarit 2022) .....	19
Figura 21: Ndjekja e kualifikimeve të mëtejshme (2018-2022) .....	21
Figura 22: Llojet e kualifikimeve të mëtejshme (2018-2022) .....	22
Figura 23: Lloji i institucionit (2020-2022) .....	23
Figura 24: Lidhja e studimeve me profesionin (2020-2022) .....	23
Figura 25: Papunësia ndër vite (2018-2022) .....	24
Figura 26: Niveli i të diplomuarve pa punë që kërkojnë për punë (2020-2021) .....	25
Figura 27: Metodatat e kërkimit për punë (2020-2022) .....	26
Figura 28: Niveli i të diplomuarve papunë që kanë qenë në marrëdhënie pune (2018-2022) .....	27
Figura 29 Përzgjedhja e së njëjtës shkollë dhe degë (2018-2022) .....	28
Figura 30: Përzgjedhja e së njëjtës degë studimi (2018-2022) .....	29
Figura 31: Përzgjedhja e së njëjtës shkollë (2018-2022) .....	29

## Lista e tabelave

Tabela 1: Mbulimi i gjurmimit .....	6
Tabela 2: Arsyet e mospërputhjes së punës me fushën e arsimit (2018-2022) .....	13
Tabela 3: Niveli i përdorimit të njohurive të fituara gjatë studimeve (2018-2022) .....	13
Tabela 4: Shkalla e lidhjes së pozicionit aktual të punës me studimet (2018-2022) .....	14
Tabela 5: Përceptimi për sigurinë dhe kënaqësinë në punën aktuale (2018-2022) .....	19
Tabela 6: Periudha kohore në kërkim të një pune (2018-2022) .....	20
Tabela 7: Mënyrat e gjetjes së punës së parë (2018-2022) .....	20
Tabela 8: Ndhima e shkollës në gjetjen e punës së parë (2018-2022) .....	21
Tabela 9: Arsyet kryesore për ndjekjen e kualifikimeve të mëtejshme (2018-2022) .....	24
Tabela 10: Arsyet kryesore pas papunësisë (2018-2022) .....	25
Tabela 11: Arsyet kryesore e mos kërkimit për punë (2020-2022) .....	26
Tabela 12: Përqindja e aspekteve ku ka nevojë për përmirësim në shkallë “shumë/jashtëzakonisht shumë” (2018-2022) .....	27
Tabela 13: Përzgjedhja e së njëjtës degë dhe shkollë sipas drejtimit (2018-2022) .....	28
Tabela 14: Planet e të diplomuarve për dy vitet e ardhshme (2018-2022) .....	30

## Tabela e përmbajtjes


<b>1. Hyrje – Çfarë është gjurmimi i të diplomuarve? .....</b>	<b>5</b>
<b>2. Të diplomuarit 2017-2022 .....</b>	<b>6</b>
<b>3. Analiza e rezultateve.....</b>	<b>8</b>
<b>3.1 Statusi i punësimit.....</b>	<b>8</b>
<b>3.2 Lidhja e punës me fushën e arsimit .....</b>	<b>11</b>
<b>3.3 Përdorimi i njohurive dhe kompetencave të fituara në shkollë në vendin e punës .....</b>	<b>13</b>
<b>3.4 Niveli i pagave.....</b>	<b>14</b>
<b>3.5 Kushtet e punës .....</b>	<b>16</b>
<b>3.6 Perceptimet mbi stabilitetin dhe kënaqshmërinë me vendin e punës.....</b>	<b>18</b>
<b>3.7 Kohëzgjatja e gjetjes së punës së parë.....</b>	<b>19</b>
<b>3.8 Mënyrat e gjetjes së punës së parë.....</b>	<b>20</b>
<b>3.9 Të diplomuarit që ndjekin kualifikime të mëtejshme .....</b>	<b>21</b>
<b>3.10 Të diplomuarit pa punë.....</b>	<b>24</b>
<b>3.11 Propozimet për përmirësim në shkollë .....</b>	<b>27</b>
<b>3.12 Planet për të ardhmen .....</b>	<b>30</b>
<b>4 Përfundime .....</b>	<b>30</b>

## 1. Hyrje – Çfarë është gjurmimi i të diplomuarve?

**Monitorimi i treguesve kryesorë të tregut të punës** për të diplomuarit e një institucioni arsimor realizohet përmes ‘studimeve gjurmuese’ që ndjekin ose ‘gjurmojnë’ të diplomuarit pasi ata diplomohen. Studimet e gjurmimit ofrojnë një tablo më të qartë të performancës së të diplomuarve të arsimit profesional në tregun e punës, duke matur punësimin produktiv të të diplomuarve pas përfundimit të studimeve.

Të dhënat dhe rezultatet e gjurmimit përdoren për të rritur kuptueshmërinë mbi **relevancën e ofertës** për kualifikime duke kontribuar kështu në zhvillimin e aftësive të kërkuara nga tregu i punës dhe në pajisjen e nxënësve me njohuritë dhe aftësitë e duhura. Tematikat e gjurmimit janë të shumëfishta, por kryesisht përfshijnë pyetje që lidhen me tranzicionin nga institucioni arsimor në tregun e punës, kushtet e punës, përputhjen midis arsimit dhe punës aktuale, si dhe vlerësimin në retrospektivë të institucionit arsimor nisur nga përvoja e të diplomuarve.


### Avantazhet e një sistemi gjurmimi në nivel ofruesi



Në këtë kuadër, **Shkolla Teknike Ekonomike Tiranë**, me mbështetjen e projektit ‘Aftësi për Punë’ (S4J) ka ngritur një **sistem gjurmimi** në nivel ofruesi për të diplomuarit e saj. Ky sistem gjurmimi përbush dy qëllime të rëndësishme:

- Monitorimin e treguesve kryesorë të tregut të punës për të diplomuarit e shkollës.
- Vlerësimin e lidhjes (përputhshmërisë horizontale) midis arsimit dhe punës.

Zbatimi i procesit të gjurmimit në praktikë zhvillohet në **tre faza kryesore** siç është e ilustruar në diagramën më poshtë.



Në fazën e para-gjurmimit, që kryhet në majin e çdo viti shkollor, realizohet para-gjurmimi i

maturantëve që pritet të diplomohen në qershor. Para-gjurmimi kryhet me anë të një pyetësi të strukturuar online. Anketa mbledh të dhënat e kontaktit të maturantëve, karakteristikat e tyre socio-demografike, si dhe planet dhe pritshmëritë e tyre të karrierës për të mundësuar kështu gjurmimin e tyre një vit më pas.

Në fazën e gjurmimit, që kryhet në qershorin e çdo viti shkollor realizohet gjurmimi i të diplomuarve nga shkolla një vit më parë. Të diplomuarit raportojnë mbi përvojën e kalimit në tregun e punës dhe bëjnë vlerësimin në retrospektivë të shkollës së tyre përmes një pyetësi të standardizuar online duke përdorur platformën Kobo Toolbox.

Në fazën përmbyllëse të procesit analizohen rezultatet e gjurmimit dhe prezantohen rezultatet. Pjesa më e rëndësishme e procesit është leximi i këtyre gjetjeve dhe reflektimi i brendshëm i institucionit mbi të dhënat dhe ndërmarrja e hapave konkrete si rrjedhojë.

Procesi i gjurmimit koordinohet nga **koordinatori i gjurmimit** me mbështetjen e Njësisë së Zhvillimit dhe mësuesve kujdestarë, nën kujdesin e projektit 'Aftësi për punë'.

Ky raport përmbledhës pasqyron rezultatet kryesore nga gjurmimi i **pesë brezave me të diplomuar** të Shkollës Teknike Ekonomike Tiranë.

## 2. Të diplomuarit 2017-2022


Në vitin shkollor 2021-2022, në Shkollën Teknike Ekonomike Tiranë (SHTET), u diplomuan 211 nxënës (shiko tabelën 1), 18 nxënës më pak sesa gjatë vitit 2020-2021.

Tabela 1: Mbulimi i gjurmimit

Brezi	Të diplomuar	Të anketuar	%
2017-2018	200	114	57%
2018-2019	260	180	69%
2019-2020	237	152	64%
2020-2021	229	80	35%
<b>2021-2022</b>	<b>211</b>	<b>149</b>	<b>71%</b>

Nga të diplomuarit e vitit 2021-2022 u gjurmuan 149 nxënës ose 71% e të diplomuarve. Shumica e të diplomuarve të gjurmuar i përkasin gjinisë femërore 58% (N=87). Ndërkohë, 42% (N=62) i përkasin gjinisë mashkullore (shiko figurën 1).


Figura 1: Shpërndarja sipas gjinisë (2022)



**Shënim:** Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N=149

Shpërndarja e të diplomuarve sipas drejtimeve jepet në figurën 2. Kështu, 91% e të diplomuarve të gjurmuar i përkasin drejtimit Ekonomi-Biznes dhe 9% drejtimit Tekstil-Konfeksione.


Figura 2: Shpërndarja sipas drejtimeve (2022)



**Shënim:** Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N=149

Të pyetur lidhur me vendbanimin, 95% e të diplomuarve të gjurmuar u përgjigjën se jetonin në Shqipëri dhe 5% (N=8) jashtë vendit. Sikurse vërehet nga figura 2, numri i të diplomuarve që jetojnë jashtë vendit nuk ka pësuar ndryshime të qënësishme gjatë tre viteve të fundit.

Figura 3: Vendbanimi i të diplomuarve (2020-2022)



**Shënim:** Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shumat e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2020 (N=152); 2021 (N=80); 2022 (N=149)


Nga të diplomuarit që jetojnë jashtë vendit, 3 (tre) jetojnë në Itali dhe 2 (dy) të tjerë në Angli. Ndërkohë, në Gjermani, Francë dhe Bullgari jeton përkatësisht nga 1 (një) i diplomuar në secilin shtet.

### 3. Analiza e rezultateve

#### 3.1 Statusi i punësimit

Sipas rezultateve të brezit të fundit të të gjurmuarve (2021-2022), nga një total prej 149 të anketuarish 30% (N=45) ishin të punësuar një vit pas diplomimit (shiko figurë 4), 5% (N=8) ishin të vetëpunësuar, 25% (N=37) ishin të punësuar por edhe studionin në të njëjtën kohë, 24% (N=36) ishin student/kursant. Ndërkohë, të papunë ishin 15% (N=23) e të anketuarve.


*Figura 4: Përfshirja në tregun e punës një vit pas diplomimit (2022)*



**Shënim:** Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N=149

Referuar figurës 5, në vitin 2022, 60% e të diplomuarve të gjurmuar ishin të punësuar një vit pas diplomimit. Viti 2022 shënon një rritje të punësimit me 7 pikë përqindje në krahasim me vitin 2021. Megjithatë, duhet theksuar se në vitin 2022, shkolla ka diplomuar 18 nxënës më pak se në vitin 2021 (referohu tabelës 1). Mesatarja e punësimit për të pestë brezat e gjurmuar është 49%. Pra, më pak sesa gjysma e të diplomuarve përfshihen në tregun e punës një vit pas diplomimit. Norma e papunësisë për të diplomuarit e vitit 2022 është 15%, po aq sa mesatarja e viteve 2018-2021. Ndërkohë, 24% e të diplomuarve në vitin 2022 janë student/kursant një vit pas diplomimit. Në raport me mesataren e viteve 2018-2021 (39%), kemi një ulje me 15 pikë përqindje. Theksojmë, për të pestë brezat e gjurmuar, numri i të diplomuarve që janë student/kursant është më i madh sesa numri i atyre që janë të papunë.


Figura 5: Përfshirja në tregun e punës një vit pas diplomimit (2018-2022)



**Shënim:** Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2018 (N=114); 2019 (N=180); 2020 (N=152); 2021 (N=80); 2022 (N=149).

Të anketuarit që janë shprehur se janë në marrëdhënie pune janë pyetur më tej nëse janë të punësuar apo të vetëpunësuar. Për vitin 2022, 30% e të diplomuarve të gjurmuar janë të punësuar dhe 5% të vetëpunësuar (shiko figurën 6). Vërehet një rritje me 7 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2018-2021 (23%) e punësimit në raport me vetëpunësimin. Ndërkohë, mesatarja e vetëpunësimit nuk ka pësuar ndryshime në dy vitet e fundit.


Figura 6: Punësimi përkundrejt vetë-punësimit (2018-2022)



**Shënim:** Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2018 (N=114); 2019 (N=180); 2020 (N=152); 2021 (N=80); 2022 (N=149)

Në figurën 7, jepet statusi i punësimit sipas drejtimeve të ofruara nga shkolla. Sikurse vihet re, 61% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes ishin të punësuar një vit pas diplomimit, 15% ishin pa punë dhe 24% ishin student/kursant. Ndërkohë, 54% e të diplomuarve në Tekstil-Konfeksione ishin të punësuar, 23% pa punë dhe po aq (23%) student/kursant.


Figura 7: Statusi i punësimit një vit pas diplomimit sipas drejtimeve (2022)



**Shënim:** Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** EB (N=136); TK (N=13)

Të ndara sipas gjinisë (shih figurën 8), të dhënat tregojnë se 51% e vajzave të diplomuara janë të punësuar, 31% studente/kursante dhe 18% të papuna. Ndërkohë, 74% e djemve të diplomuar janë të punësuar, 15% student/kursant dhe 11% të papunë. Për të dy gjinitë vihet re se numri i të diplomuarve që janë student/kursant është më i lartë sesa numri i të papunëve.

Figura 8: Statusi i punësimit një vit pas diplomimit sipas gjinisë (2022)




**Shënim:** Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shumta e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** M (N=62); F (N=87)

### 3.2 Lidhja e punës me fushën e arsimit

Të pyetur nëse puna aktuale lidhet me fushën e tyre të arsimit, vetëm 34% e të diplomuarve në vitin 2022 u përgjigjën pozitivisht. Ndërkohë, 66% pohuan se puna që bëjnë nuk ka lidhje me fushën e tyre të arsimit. Në këtë aspekt kemi një përkeqësim me 16 pikë përqindje në raport me një vit më parë ku 50% e të diplomuarve pohonin se puna që bënin lidhej me fushën e tyre të arsimit. Nga viti 2018-2021 (shiko figurën 9), mesatarisht 44% e të diplomuarve pohojnë se puna lidhet me fushën e tyre të arsimit dhe 56% se puna nuk lidhet me fushën e tyre të arsimit.

Figura 9: Lidhja e punës me fushën e arsimit (2018-2022)




**Shënim:** Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shumta e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2018 (N=29); 2019 (N=81); 2020 (N=91); 2021 (N=42); 2022 (N=90)

Nëse analizojmë lidhjen e punës me fushën e arsimit sipas drejtimit (shiko figurën 10), vërehet se mesatarisht 35% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes dhe 29% e të diplomuarve në Tekstil-

Konfeksione janë të punësuar në profesion. Krahasuar me mesataren e viteve 2020-2021, të dhënat tregojnë një ulje me 11 pikë përqindje të punësimit të lidhur me fushën e arsimit për të diplomuarit në Ekonomi-Biznes. Ndërkohë, vërehet një rritje me 3 pikë përqindje e punësimit në profesion për të diplomuarit në Tekstil-Konfeksione në raport me mesataren e viteve 2020-2021.


Figura 10: Lidhja e punës me fushën e arsimit sipas drejtimit (2020-2022)



**Shënim:** Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shumta e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza 2020:** N<sub>EB</sub>=82, N<sub>TK</sub>=9; **Baza 2021:** N<sub>EB</sub>=37, N<sub>TK</sub>=5; **Baza 2022:** N<sub>EB</sub>=83, N<sub>TK</sub>=7

Të ndara sipas gjinisë, të dhënat tregojnë se 33% e të diplomuarve të gjinisë mashkullore dhe 36% e të diplomuarave të gjinisë femërore punojnë në profesion. Për të dyja gjinitë, punësimi në profesion është relativisht i ulët.

Figura 11: Lidhja e punës me arsimin sipas gjinisë (2022)



**Shënim:** Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shumta e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: M** (N=46); **F** (N=44)

Të pyetur lidhur me arsyet e mospërputhjes së punës me fushën e arsimit (shiko tabelën 2), vërehet se të diplomuarit e brezit 2021-2022 japin dy arsye kryesore: (i) pamundësia për të gjetur një vend

pune që lidhet me studimet (50% në 2022, mesatarja (2018-2021) 61%), si dhe (ii) paga/kushtet më të mira të punës aktuale (31% në 2022, mesatarja (2018-2021) 17%).

Tabela 2: Arsyet e mospërputhjes së punës me fushën e arsimit (2018-2022)

	Të diplomuar në 2018	Të diplomuar në 2019	Të diplomuar në 2020	Të diplomuar në 2021	Të diplomuar në 2022
Nuk gjeta një vend pune që lidhet me studimet e mia	62%	62%	63%	55%	50%
Nuk dua të punoj në një punë që lidhet me studimet e mia	0%	11%	6%	5%	9%
Nuk ka oferta pune në fushën time në rajon	15%	14%	4%	5%	6%
Puna që kam më ofron pagë/kushte më të mira	8%	14%	23%	25%	31%
Tjetër	15%	0%	4%	10%	4%

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. Baza: 2018 (N=13); 2019 (N=37); 2020 (N=52); 2021 (N=20); 2022 (N=54)

### 3.3 Përdorimi i njohurive dhe kompetencave të fituara në shkollë në vendin e punës

Të pyetur nëse njohuritë dhe kompetencat e fituara gjatë studimit i përdorin në vendin e punës (shiko tabelën 3), rezultatet e gjurmimit të të diplomuarve në vitin 2022 tregojnë se njohuritë përdoren “shumë/jashtëzakonisht shumë” nga 30% e të gjurmuarve. Në këtë aspekt vihet re një rritje me 2 pikë përqindje në krahasim me vitin e mëparshëm.

Ndërkohë, 20% e të diplomuarve të gjurmuar janë përgjigjur se i përdorin “aspak” njohuritë e fituara gjatë studimeve. Mesatarja për këtë kategori për vitet 2018-2021 ka qenë 27%. Pra, kemi për vitin 2022 një ulje me 7 pikë përqindje të numrit të të diplomuarve të cilët pohojnë se nuk i përdorin “aspak” njohuritë e fituara në shkollë në vendin e punës. Ndërsa kategoria e atyre që janë përgjigjur se i përdorin “disi” për vitin 2022 është 26%. Mesatarja për këtë kategori për vitet 2018-2021 ka qenë 28%. Pra, kemi një ulje me 2 pikë përqindje të të diplomuarve të cilët pohojnë që i përdorin disi njohuritë e fituara në shkollë.

Tabela 3: Niveli i përdorimit të njohurive të fituara gjatë studimeve (2018-2022)

	Aspak	2	3	4	Jashtëzakonisht shumë
Të diplomuar në 2018	24%	28%	28%	17%	3%
Të diplomuar në 2019	30%	6%	24%	24%	15%
Të diplomuar në 2020	34%	16%	19%	13%	18%
Të diplomuar në 2021	19%	12%	40%	21%	7%
Të diplomuar në 2022	20%	24%	26%	17%	13%

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. Baza: 2018 (N=29); 2019 (N=94); 2020 (N=91); 2021 (N=42); 2022 (N=90)

Të pyetur për lidhjen mes pozicionit të punës dhe studimeve të kryera (shiko tabelën 4), 23% e të diplomuarve në vitin 2022 e vlerësojnë lidhjen e pozicionit të punës me studimet e kryera me “shumë/jashtëzakonisht shumë”. Nga ana tjetër, 47% e vlerësojnë me “pak/aspak” lidhjen mes pozicionit të punës dhe studimit. Mesatarisht, 22% e të diplomuarve në vitet 2018-2021 e vlerësojnë lidhjen mes pozicionit të punës dhe studimeve “shumë/jashtëzakonisht shumë” dhe 52% me “pak/aspak”.

Tabela 4: Shkalla e lidhjes së pozicionit aktual të punës me studimet (2018-2022)


	Aspak	2	3	4	Jashtëzakonisht shumë
Të diplomuar në 2018	34%	21%	28%	14%	3%
Të diplomuar në 2019	31%	13%	26%	19%	12%
Të diplomuar në 2020	36%	22%	14%	11%	16%
Të diplomuar në 2021	31%	21%	33%	7%	7%
Të diplomuar në 2022	29%	18%	30%	10%	13%

**Shënim:** Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2018 (N=29); 2019 (N=94); 2020 (N=91); 2021 (N=42); 2022 (N=90)

### 3.4 Niveli i pagave

Përsa i përket nivelit të pagave për të diplomuarit e punësuar, një vit pas diplomimit, për vitin 2022 (shiko figurën 11), shpërndarja e të diplomuarve sipas nivelit të pagave është: 4% më pak se paga minimale, 11% paga minimale – 35,000 lekë, 44% në fashën 35,001 – 50, 000 lekë, 14% në fashën 50,001 – 65, 000 lekë, 11% në fashën 65,001 – 80,000 lekë dhe 14% paguhen më shumë se 80,001 lekë.


Figura 12: Niveli i pagave një vit pas diplomimit (net) 2022



**Shënim:** Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N=90

Një vlerësim krahasues me vitet e kaluara (shiko figurën 12), pasqyron një përmirësim të nivelit të pagave të të diplomuarve. Përqindja e të gjurmuarve që kanë pagë më të ulët se 35.000 lekë është ulur me 29 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2018-2021 (40% mesatarja, 11% në 2022). Ndërkohë, është rritur me 6 pikë përqindje niveli i të diplomuarve që kanë një pagë 50,001 - 65,00 lekë (8% mesatarja, 14% në 2022). Për më tepër, 14% e të diplomuarve në 2022 marrin më shumë se 80,000 lekë, me një rritje me 5 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2018-2021 (9%).


Figura 13: Niveli i pagave një vit pas diplomimit (net)(2018-2022)



**Shënim:** Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2018 (N=29); 2019 (N=81); 2020 (N=91); 2021 (N=42); 2022 (N=90)

Sipas të dhënave të disagreguara sipas drejtimeve (shiko figurën 14), vëmë re se përkatësisht 4% (N=3) e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes dhe 14% (N=1) e të diplomuarve në Tekstil-Konfeksione paguhen më pak sesa paga minimale. Ndërkohë, 10% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes dhe 29% e të diplomuarve në Tekstil-Konfeksione paguhen deri në 35,000 lekë. Për më tepër, 47% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes dhe 14% e të diplomuarve në Tekstil-Konfeksione paguhen mes 35,001 dhe 50,000 lekë. Gjithashtu, 14% e të diplomuarve në të dy drejtimet paguhen 50,001 - 65,000 lekë. Ndërkohë, 12% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes paguhen 65,001 – 80,000 lekë. Për më tepër, 13% (N=11) e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes dhe 29% (N=2) e të diplomuarve në Tekstil-Konfeksione paguhen më shumë se 80,001 lekë.


Figura 14: Niveli i pagave sipas drejtimit (2022)



**Shënim:** Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N<sub>EB</sub>=83; N<sub>TK</sub>=7

Nga të dhënat e disagreguara sipas gjinisë (figura 15), shohim se 4% (N=2) e djemve të diplomuar dhe 18% (N=8) e vajzave të diplomuara marrin një pagë më të vogël se 35,000 lekë. Ndërkohë, 46% e djemve dhe 43% e vajzave marrin një pagë 35,001 – 50,000 lekë. Për më tepër, 20% e djemve dhe 9% e vajzave marrin një pagë mes 50,001 dhe 65,000 lekë. Gjithashtu, 13% e djemve dhe 9% e vajzave paguhen 65,001 – 80,000 lekë. Një pagë më të lartë se 80,001 lekë e marrin 15% (N= 7) e djemve dhe 14% (N=6) e vajzave një vit pas diplomimit.

Figura 15: Niveli i pagave sipas gjinisë (2022)




**Shënim:** Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shumta e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** M (N=46); F (N=44).

### 3.5 Kushtet e punës

Të pyetur lidhur me karakteristikat kryesore të punës (me kohë të plotë apo të pjesshme), për të pestë brezat e gjurmuar vërehet që mbizotëron punësimi me kohë të plotë. Mesatarisht, 70% e të diplomuarve (2018-2022) punojnë me kohë të plotë një vit pas diplomimit. Përqindjen më të ulët të punësimit me kohë të plotë e kanë pasur të diplomuarit e vitit 2021 me 63%. Në të njëjtin vit (2021), vërehet një rritje e numrit të atyre që punojnë me kohë të pjesshme. Për vitin 2022, vërehet një ulje me 12 pikë përqindje e të diplomuarve që punojnë me kohë të plotë sezonale (1% në 2022, 13% në 2021).


Figura 16: Punësimi me kohë të plotë përkundrejtë punësimit me kohë të pjesshme (2018-2022)



**Shënim:** Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2018 (N=21); 2019 (N=70); 2020 (N=80); 2021 (N=38); 2022 (N=82)

Për sa i përket shpërndarjes së të diplomuarve sipas tipologjisë së kompanisë (shiko figurën 17), në brezin e fundit të të gjurmuarve (2022) vërehet se 41% e të diplomuarve punojnë në kompani me më shumë se 50 punonjës, 22% në kompani me 10 – 49 punonjës dhe 22% të tjerë në kompani me 5 – 9 punonjës. Mesatarisht, nga viti 2018 – 2021, 29% e të diplomuarve janë punësuar në kompani me mbi 50 punonjës, 20% në kompani me 10 – 49 punonjës, 28% në kompani me 5 – 9 punonjës dhe 23% në kompani me 1 – 4 punonjës.


Figura 17: Madhësia e kompanisë (2018-2022)



**Shënim:** Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2018 (N=21); 2019 (N=70); 2020 (N=80); 2021 (N=38); 2022 (N=82)

Në vitin 2022, 62% e të diplomuarve kanë një kontratë pune me punëdhënësin e tyre (shiko figurën 18). Nga ku, 40% kanë një kontratë pune me afat të pacaktuar dhe 22% me afat të caktuar. Ndërkohë, 37% nuk kanë një kontratë. Ndonëse numri i këtyre të fundit mbetet i lartë, vërehet një përmirësim me 4 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2018-2021 ku 41% e të diplomuarve nuk kishin një kontratë pune me punëdhënësin.


Figura 18: Lloji i kontratës (2018-2022)



**Shënim:** Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2018 (N=20); 2019 (N=70); 2020 (N=80); 2021 (N=38); 2022 (N=82)

Sipas rezultateve të gjurmimit të të pesë brezave, 82% e të diplomuave të punësuar deklarojnë se iu paguhen kontributet e detyrueshme nga ana e punëdhënësit (shiko figurën 19). Ndërkohë, mesatarisht 14% deklarojnë se nuk iu paguhen sigurimet nga punëdhënësi dhe vetëm 4% shprehen se nuk kanë informacion nëse iu paguhen apo jo sigurimet.

Figura 19: Ndërgjegjësimi rreth pagesës së sigurimeve nga punëdhënësi (2018-2022)



**Shënim:** Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2018 (N=21); 2019 (N=70); 2020 (N=80); 2021 (N=38); 2022 (N=82)

### 3.6 Perceptimet mbi stabilitetin dhe kënaqshmërinë me vendin e punës

Të pyetur se sa të sigurt dhe të stabilizuar ndjeheshin në vendin e tyre të punës, 71% e të diplomuarve në vitin 2022, u shprehën se ndjehen “të sigurt ose shumë të sigurt” (shiko tabelën 5). Përkatesisht 27% e të diplomuarve në vitin 2022 janë shprehur se ndjehen “shumë të sigurt” në vendin e punës, me një rritje 5 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2018-2021 (22%). Ndërkohë, të diplomuarit që janë shprehur “shumë të pasigurt” janë vetëm 5%, po aq sa mesatarja e viteve 2018-2021.

Të pyetur lidhur me kënaqësinë në vendin e punës, 66% e të diplomuarve në vitin 2022 shprehen se ndjehen “të kënaqur ose shumë të kënaqur” dhe vetëm 1% shprehen “shumë të pakënaqur”. Sikurse e tregon edhe tabela 5, vërehet një korrelacion pozitiv mes sigurisë dhe kënaqësisë në vendin e punës.

Tabela 5: Përceptimi për sigurinë dhe kënaqësinë në punën aktuale (2018-2022)


	Të diplomuar në 2018	Të diplomuar në 2019	Të diplomuar në 2020	Të diplomuar në 2021	Të diplomuar në 2022
Shumë i/e pasigurt	1 (5%)	5 (7%)	5 (6%)	1 (3%)	4 (5%)
I/e pasigurt	3 (14%)	11 (16%)	2 (3%)	2 (5%)	3 (4%)
Neutral	10 (48%)	11 (16%)	25 (31%)	10 (26%)	17 (21%)
I/e sigurt	6 (29%)	29 (41%)	25 (31%)	12 (32%)	36 (44%)
Shumë i/e sigurt	1 (5%)	14 (20%)	23 (29%)	13 (34%)	22 (27%)
Shumë i/e pakënaqur	0%	2 (3%)	7 (9%)	1 (3%)	1 (1%)
I/e pakënaqur	2 (10%)	10 (14%)	3 (4%)	1 (3%)	8 (10%)
Neutral	13 (62%)	8 (11%)	12 (15%)	7 (18%)	19 (23%)
I/e kënaqur	6 (29%)	35 (50%)	33 (41%)	17 (45%)	38 (46%)
Shumë i/e kënaqur	0%	15 (21%)	25 (31%)	12 (32%)	16 (20%)

**Shënim:** Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2018 (N=21); 2019 (N=70); 2020 (N=80); 2021 (N=38); 2022 (N=82)

### 3.7 Kohëzgjatja e gjetjes së punës së parë

Të pyetur për kohën që u duhet të presin derisa të fillojnë punën e tyre të parë, 56% e të diplomuarve në vitin 2022 u përgjigjën se kanë arritur të gjejnë punë para diplomimit dhe 13% 1 muaj pas diplomimit. Ndërkohë, përkatësisht nga 8% e kanë gjetur punën 1 – 3 muaj pas diplomimit dhe 3 – 6 muaj pas diplomimit. Vetëm 7% e të diplomuarve kanë arritur të gjejnë punë 9 – 12 muaj pas diplomimit.

Figura 20: Periudha kohore në kërkim të një pune (të diplomuarit 2022)



**Shënim:** Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N=91

Në një vështirësi krahasues me vitet e mëparshme (shiko tabelën 6), mesatarisht 61% e të diplomuarve gjatë viteve 2018 – 2021 kanë arritur të gjejnë punë para diplomimit. Në këtë aspekt kemi një rënie

me 5 pikë përqindje për vitin 2022 ku 56% e të diplomuarve arritën të gjejnë një punë para diplomimit. Ndërkohë, mesatarisht 8% e të diplomuarve arrijnë të gjejnë punë 1 muaj pas diplomimit (2018 – 2021). Në këtë kategori kemi një ndryshim me 5 pikë përqindje për vitin 2022 ku 13% e të diplomuarve gjejnë punë 1 muaj pas diplomimit. Ndryshim me 1 pikë përqindje kemi në kategorinë e atyre që e gjejnë punën 1 – 3 muaj pas diplomimit (8% 2022, 9% mesatarja e viteve 2018 – 2021).

Ndërkohë përmirësim me 2 pikë përqindje vërehet edhe në numrin e atyre të diplomuarve që gjejnë punë 3-6 muaj pas diplomimit (8% në 2022, përkundrajt 10% (mesatarja) në vitet 2016-2021). Vlen të theksohet se përqindja e atyre që gjejnë punë 1 vit pas diplomimit vijon të mbetet 0 (zero) për të pestin vit radhazi.

Tabela 6: Periudha kohore në kërkim të një pune (2018-2022)

	Të diplomuar në 2018	Të diplomuar në 2019	Të diplomuar në 2020	Të diplomuar në 2021	Të diplomuar në 2022
Para diplomimit	47%	66%	49%	81%	<b>56%</b>
1 muaj pas diplomimit	7%	7%	12%	5%	<b>13%</b>
1 - 3 muaj pas diplomimit	3%	12%	14%	7%	<b>8%</b>
3 - 6 muaj pas diplomimit	30%	4%	6%	2%	<b>8%</b>
6 - 9 muaj pas diplomimit	3%	6%	9%	5%	<b>9%</b>
9 - 12 muaj pas diplomimit	10%	5%	9%	0%	<b>7%</b>
Më shumë se 1 vit pas diplomimit	47%	66%	49%	81%	<b>56%</b>

**Shënim:** Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2018 (N=30); 2019 (N=83); 2020 (N=85); 2021 (N=43); 2022 (N=91)

### 3.8 Mënyrat e gjetjes së punës së parë

Të pyetur për mënyrën e gjetjes së punës së parë, vërehet se për të pestë brezat e gjurmuar lidhjet personale të pjesëtarëve të familjes dhe të njohurit e tyre janë forma më e zakonshme nëpërmjet së cilës të diplomuarit kanë gjetur punë për herë të parë. Mesatarisht 58% e të diplomuarve gjatë viteve 2018 – 2021 gjejnë punë nëpërmjet lidhjeve personale. Tek të diplomuarit e vitit 2022 kjo përqindje është 62%, pra kemi një rritje me 4 pikë përqindje në këtë kategori.

Mënyrë tjetër për gjetjen e punës së parë është edhe nëpërmjet njoftimeve për punë në faqe interneti, media sociale dhe gazeta. Mesatarja e viteve 2018 – 2021 ka qenë 29%, ndërkohë për vitin 2022 është 23%. Pra vërehet një rritje me 6 pikë përqindje të atyre që e gjejnë punën nëpërmjet njoftimeve për punë. Mënyra e tretë që mbizotëron është duke kontaktuar drejtëpërdrejtë me punëdhënësit. Mesatarja e viteve 2018 – 2021 ka qenë 10%, në vitin 2022 është 9%. Vlen të theksohet se për të parin vit, mësuesit janë evidentuar si një mënyrë për gjetjen e punës së parë (2% viti 2022, 0% 2018 -2021). Gjithashtu, për vitin 2022 vërehet një rritje e numrit të atyre që e gjejnë punën e parë nëpërmjet praktikës profesionale në biznes (4% 2022, 1% për vitet 2018 – 2021).

Tabela 7: Mënyrat e gjetjes së punës së parë (2018-2022)

	Të diplomuar në 2018	Të diplomuar në 2019	Të diplomuar në 2020	Të diplomuar në 2021	Të diplomuar në 2022
Nga njoftimet për punë në faqe interneti, media sociale, gazetë	33%	29%	25%	30%	<b>23%</b>
Nga njohjet, lidhjet familjare, miqtë	63%	57%	52%	60%	<b>62%</b>
Nga praktika profesionale në biznes	0%	1%	2%	0%	<b>4%</b>
Duke kontaktuar drejtëpërdrejtë me punëdhënësin tim	3%	12%	16%	7%	<b>9%</b>

Nga mësuesit	0%	0%	0%	0%	<b>2%</b>
Nga Zyra e Punësimit	0%	0%	1%	0%	<b>0%</b>
Tjetër	0%	1%	4%	2%	<b>0%</b>

**Shënim:** Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2018 (N=30); 2019 (N=83); 2020 (N=85); 2021 (N=43); 2022 (N=91)

Lidhur me mënyrat e mbështetjes së shkollës në kapërcimin e fazës tranzitore drejt tregut të punës (shiko tabelën 8), në vitin 2022, 33% pohuan se shkolla i ka mësuar se si të aplikojnë për punë (vërehet ulje me 10 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2018 – 2021 (44%)), 27% pohuan se i ka ndihmuar në orientimin mbi mundësitë e ndryshme për punësim (vërehet ulje me 8 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2018 – 2021 (35%)). Gjithashtu, mbetet i lartë numri i atyre që pohojnë se përgjithësisht shkolla nuk i ka ndihmuar në gjetjen e punës së parë. Kështu, në vitin 2022, 32% e të diplomuarve të gjurmuar pohojnë se shkolla përgjithësisht nuk i ka ndihmuar. Në këtë aspekt kemi një rritje me 3 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2018 – 2021 (29%).

Tabela 8: Ndihma e shkollës në gjetjen e punës së parë (2018-2022)


	Të diplomuar në 2018	Të diplomuar në 2019	Të diplomuar në 2020	Të diplomuar në 2021	Të diplomuar në 2022
Kam mësuar si të kërkoj dhe të aplikoj për punë	59%	37%	33%	48%	33%
Më ka orientuar mbi mundësitë e ndryshme të punësimit	59%	43%	25%	14%	27%
Më ka ndihmuar për të vendosur kontakte me punëdhënës potencialë	45%	34%	4%	5%	18%
Përgjithësisht nuk më ka ndihmuar	21%	22%	44%	31%	32%
Tjetër	0%	1%	3%	5%	6%

**Shënim:** Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2018 (N=29); 2019 (N=94); 2020 (N=91); 2021 (N=42); 2022 (N=90)

### 3.9 Të diplomuarit që ndjekin kualifikime të mëtejshme

Për vitin 2022, 25% e të diplomuarve të gjurmuar pohojnë se janë të punësuar por edhe studiojnë në të njëjtën kohë. Kjo mesatare për vitet 2018 – 2021 ka qenë 17%. Në këtë aspekt kemi një rritje me 8 pikë përqindje të të diplomuarve të cilët punojnë dhe studiojnë në të njëjtën kohë. Ndërkohë, 24% e të diplomuarve të gjurmuar për vitin 2022 shprehen se janë student/kursant. Këtu vërehet një ulje me 15 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2018 – 2021 e cila ka qenë 39%.


Figura 21: Ndjekja e kualifikimeve të mëtejshme (2018-2022)



**Shënim:** Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2018 (N=114); 2019 (N=180); 2020 (N=152); 2021 (N=80); 2022 (N=149)

Sikurse në vitet paraardhëse, pjesa më e madhe e të diplomuarve në 2022 që ndjekin kualifikime të mëtejshme kanë zgjedhur universitetin (97%, 71 nga 73 të gjurmuar) dhe vetëm 1% (1 nga 73), studiojnë pranë një shkolle profesionale pas të mesmes dhe 1% (1 nga 73) ndjekin një kurs profesional.


Figura 22: Llojet e kualifikimeve të mëtejshme (2018-2022)



**Shënim:** Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2018 (N=72); 2019 (N=100); 2020 (N=77); 2021 (N=43); 2022 (N=73)

Nga të diplomuarit që ndjekin studime të mëtejshme, 64% (N=47) studiojnë në institucione publike dhe 36% (N=26) në ato private. Në dy vitet e mëparshme (2022-2021), mesatarja ka qenë 61% në institucione publike dhe 39% në ato private. Pra vërehet një luhatje me vetëm 3 pikë përqindje për vitin 2022 për të dy llojet e institucioneve.


Figura 23: Lloji i institucionit (2020-2022)



**Shënim:** Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2020 (N=77); 2021 (N=43); 2022 (N=73)

Ndërkohë, të pyetur nëse studimet/trajnimet që po ndjekin lidhen me shkollën që kanë bërë (shiko figurën 24), 86% (63 nga 73) e të gjurmuarve që studiojnë janë shprehur se fusha e studimeve që po ndjekin tani lidhet me shkollën që kanë bërë, përkundëjtë 14% (10 nga 73) të cilët shprehen se studimet e mëtejshme nuk lidhen me shkollën që kanë bërë. Nga viti 2020 deri në 2022 mesatarisht 79% e të gjurmuarve u shprehën se studimet/trajnimet që ndjekin lidhen me shkollën që kanë bërë, përkundëjtë 21% të cilët pohojnë se nuk lidhen.

Figura 24: Lidhja e studimeve me profesionin (2020-2022)



**Shënim:** Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2020 (N=77); 2021 (N=43); 2022 (N=73)

Të pyetur mbi arsyet e ndjekjes së studimeve të mëtejshme (shiko tabelën 9), 52% e të diplomuarve në 2022 janë përgjigjur për të fituar një kualifikim më të lartë (41% mesatarja e viteve 2018-2021);

26% për të rritur mundësitë për të gjetur një punë më të mirë (43% mesatarja e viteve 2018-2021); dhe 21% për të ndjekur një karrierë tjetër profesionale (12% mesatarja e viteve 2018-2021).

Tabela 9: Arsyet kryesore për ndjekjen e kualifikimeve të mëtejshme (2018-2022)


	Të diplomuar në 2018	Të diplomuar në 2019	Të diplomuar në 2020	Të diplomuar në 2021	Të diplomuar në 2022
Për të fituar një kualifikim më të lartë	36%	29%	62%	35%	52%
Për të rritur mundësitë për të gjetur një punë më të mirë	39%	56%	19%	56%	26%
Për të ndjekur një karrierë tjetër profesionale	14%	13%	14%	7%	21%
Nuk po gjeja dot punë	10%	1%	3%	0%	0%
Tjetër	1%	0%	1%	2%	1%

**Shënim:** Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2018 (N=72); 2019 (N=68); 2020 (N=77); 2021 (N=43); 2022 (N=73)

### 3.10 Të diplomuarit pa punë

Niveli i të diplomuarve të papunë një vit pas diplomimit për vitin 2022 është 15%, po aq sa mesatarja e viteve 2018-2021.


Figura 25: Papunësia ndër vite (2018-2022)



**Shënim:** Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2018 (N=114); 2019 (N=180); 2020 (N=152); 2021 (N=80); 2022 (N=149)

Të pyetur nëse po kërkonin punë, 13 nga 23 të diplomuarit e papunë të vitit 2022 u përgjigjën që po. E shprehur në përqindje 57% e të diplomuarve të papunë janë në kërkim të një pune. Një vit më parë 9 nga 13 të diplomuarit e papunë janë shprehur se ishin në kërkim të një pune.

Figura 26: Niveli i të diplomuarve pa punë që kërkojnë për punë (2020-2021)



**Shënim:** Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shumta e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2020 (N=24); 2021 (N=13); 2022 (N=23)

Një vlerësim krahasues me vitet e kaluara (shiko tabelën 10), nxjerr në pah se arsyet më madhore që mendohet se sjellin pamundësinë për të gjetur një punë janë: (i) mungesa e eksperiencës në punë (38% në 2022, 27% në vitet 2018-2021), (ii) mungesa e njohjeve/kontakteve të duhura për të gjetur një punë (31% në vitin 2022, 24% në vitet 2018-2021). Një arsye tjetër është mospërputhja e ofertës për punë me arsimin (8% në 2022, 10% në vitet 2018-2021). Ndërkohë, dy vitet e fundit një arsye që japin të diplomuarit e gjurmuar është edhe ajo e mospërputhjes së njohurive të marra në shkollë me tregun e punës (11% në 2021, 8% në 2022).


Tabela 10: Arsyet kryesore pas papunësisë (2018-2022)

	Të diplomuar në 2018	Të diplomuar në 2019	Të diplomuar në 2020	Të diplomuar në 2021	Të diplomuar në 2022
Më mungon eksperiencia e punës	0%	19%	57%	33%	38%
Njohuritë që kam marrë nga shkolla nuk përputhen me tregun e punës	0%	0%	0%	11%	8%
Ofertat për punë nuk lidhen me arsimimin tim	17%	6%	7%	11%	8%
Nuk kam njohjet/kontaktet e duhura për të gjetur një punë	25%	16%	21%	33%	31%
Nuk ka punë në qarkun tim	33%	6%	7%	0%	8%
Jam i/e angazhuar në punë familjare	0%	6%	0%	0%	0%
Nga situata e krijuar nga pandemia e COVID-	0%	39%	0%	0%	0%
Tjetër	25%	6%	7%	11%	8%

**Shënim:** Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shumta e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2018 (N=12); 2019 (N=31); 2020 (N=14); 2021 (N=9); 2022 (N=13)

Të pyetur rreth formave që përdorin për të kërkuar një vend pune (shiko figurën 27), 85% e të diplomuarve në vitin 2022 japin si metodë kryesore njoftimet për punë në faqe interneti, media sociale, gazeta etj, 23% nëpërmjet njohjeve, lidhjeve familjare, miqve dhe të njohurve dhe 31% duke kontaktuar drejtpërdrejtë me bizneset (duke dërguar CV). Vëreni, se të gjurmuarit mund të zgjedhin më shumë se një alternativë për këtë pyetje. Numri i të diplomuarve që pohojnë se e kërkojnë punën përmes zyrave të punës mbetet i vogël (1 i gjurmuar në vitin 2022 dhe 1 në vitin 2020).

Figura 27: Metodatat e kërkimit për punë (2020-2022)



**Shënim:** Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shumata e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2020 (N=14); 2021 (N=9); 2022 (N=13)

Të pyetur për arsyet e mos kërkimit për punë (shiko tabelën 11), 5 nga 10 të diplomuarit e papunë u shprehën se kishin në plan të largoheshin nga vendi. Një vit më parë asnjë nga të diplomuarit e papunë nuk kishte në plan të largoheshin nga vendi. Ndërkohë, 3 nga 10 të diplomuarit e papunë janë shprehur se nuk kanë dëshirë të punojnë për momentin. Një vit më parë (2021), 3 nga 4 të diplomuarit e papunë u shprehën se nuk kishin dëshirë të punonin për momentin. Për më tepër, 1 (një) i diplomuar është shprehur se po pret të fillojë punë së shpejti dhe një tjetër se nuk ka besim se do të gjejë punë.

Tabela 11: Arsyet kryesore e mos kërkimit për punë (2020-2022)


	Të diplomuar në 2020	Të diplomuar në 2021	Të diplomuar në 2022
Po pres të filloj punë së shpejti	10%	25%	10%
Nuk kam besim se do gjej një punë	10%	0%	10%
Nuk kam dëshirë të punoj për momentin	40%	75%	30%
Kam në plan të largohem nga vendi	40%	0%	50%

**Shënim:** Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shumata e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2020 (N=10); 2021 (N=4); 2022 (N=10)

Sikurse e tregon edhe figura 28, niveli i të diplomuarve të papunë që kanë qenë në marrëdhënie pune më parë është ulur nga viti 2018 deri në vitin 2020, dhe më pas ka pësuar sërish një rritje në vitin

2021 dhe 2022. Mesatarisht, nga viti 2018 deri në vitin 2022, 43% e të diplomuarve të papunë kanë qenë më herët në marrëdhënie pune.

Figura 28: Niveli i të diplomuarve papunë që kanë qenë në marrëdhënie pune (2018-2022)



**Shënim:** Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2018 (N=12); 2019 (N=31); 2020 (N=24); 2021 (N=13); 2022 (N=23)

### 3.11 Propozimet për përmirësim në shkollë

Të pyetur se për çfarë aspektesh ka nevojë për përmirësim shkolla me qëllim përgatitjen më të mirë të nxënësve për tregun e punës, të gjurmuarit pohuan se të gjitha aspektet e shkollës të paraqitura në tabelën 12 kanë “shumë/jashtëzakonisht shumë” nevojë për përmirësim. Theksi këtë vit, është sërish tek nevoja për përmirësim të praktikës në biznes, 66% (me një rritje me 20 pikë përqindje krahasuar me mesataren e viteve 2018-2021 (46%)). Për më tepër, kërkohet të përmirësohet bashkëpunimi me zyrat e punësimit (65%), praktika në shkollë (64%), bashkëpunimi me bizneset (61%) dhe këshillimi i karrierës (60%).


Tabela 12: Përqindja e aspekteve ku ka nevojë për përmirësim në shkollë “shumë/jashtëzakonisht shumë” (2018-2022)

	Të diplomuar në 2018	Të diplomuar në 2019	Të diplomuar në 2020	Të diplomuar në 2021	Të diplomuar në 2022
Infrastruktura	31%	27%	47%	27%	38%
Kurrikula	38%	28%	53%	35%	43%
Tekstet dhe materialet	31%	28%	56%	37%	45%
Metodat e mësimdhënies	38%	33%	51%	33%	49%
Aftësitë teorike dhe praktike të mësuesve	21%	35%	52%	26%	47%
Praktika në shkollë	28%	37%	64%	48%	64%
Praktika në biznes	28%	44%	69%	42%	66%
Këshillimi i karrierës	31%	44%	62%	34%	60%
Bashkëpunimi me bizneset	28%	50%	70%	41%	61%
Bashkëpunimi me zyrat e punësimit	24%	56%	65%	38%	65%

**Shënim:** Kjo është pyetje ku janë marrë të dhënat e të diplomuarve që janë përgjigjur “shumë/jashtëzakonisht shumë”. Shuma e përqindjeve nuk është e barabartë me 100%. **Baza:** 2018 (N=29); 2019 (N=94); 2020 (N=146); 2021 (N=71); 2022 (N=130)

Nëse do të kishin mundësi, 81% e të diplomuarve do të zgjidhnin të njëjtin drejtim profesional dhe 86% të njëjtën shkollë (shiko figurën 29). Mesatarisht, nga viti 2018-2022, 81% e të diplomuarve do të përzgjidhnin të njëjtën degë, dhe 82% të njëjtën shkollë.

Figura 29 Përzgjedhja e së njëjtës shkollë dhe degë (2018-2022)



**Shënim:** Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shumta e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2018 (N=114); 2019 (N=180); 2020 (N=152); 2021 (N=80); 2022 (N=149)

Të disagreguara sipas drejtimeve, përzgjedhja e të njëjtës degë dhe shkollë paraqitet në tabelën 13. Për vitin 2022, 81% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes dhe 85% e të diplomuarve në Tekstil-Konfeksione do të përzgjidhnin të njëjtën shkollë. Ndërkohë, 86% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes dhe 85% e të diplomuarve në Tekstil-Konfeksione do të përzgjidhnin të njëjtën degë. Mesatarisht (2018-2021), 82% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes dhe 74% e të diplomuarve në Tekstil-Konfeksione do të përzgjidhnin të njëjtën degë. Ndërkohë, mesatarisht (2018-2021), 82% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes dhe 74% e të diplomuarve në Tekstil-Konfeksione do të përzgjidhnin të njëjtën shkollë.


Tabela 13: Përzgjedhja e së njëjtës degë dhe shkollë sipas drejtimit (2018-2022)

		Ekonomi-Biznes	Tekstil-Konfeksione
Të diplomuar në 2018	Degë	78%	75%
	Shkollë	80%	75%
Të diplomuar në 2019	Degë	89%	78%
	Shkollë	94%	100%
Të diplomuar në 2020	Degë	80%	62%
	Shkollë	81%	69%
Të diplomuar në 2021	Degë	81%	83%
	Shkollë	74%	50%
Të diplomuar në 2022	Degë	81%	85%
	Shkollë	86%	85%

**Shënim:** Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shumta e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza 2018:** N<sub>EB</sub>=110, N<sub>TK</sub>=4; **Baza 2019:** N<sub>EB</sub>=171, N<sub>TK</sub>=9; **Baza 2020:** N<sub>EB</sub>=139, N<sub>TK</sub>=13; **Baza 2021:** N<sub>EB</sub>=68, N<sub>TK</sub>=12; **Baza 2022:** N<sub>EB</sub>=136, N<sub>TK</sub>=13

Të ndara sipas gjinisë përzgjedhja e të njëjtës degë studimi jepet në figurën 30. Sikurse vihet re, për vitin 2022, 81% e të diplomuarve të gjinisë mashkullore dhe 82% e të diplomuarave të gjinisë femërore do të përzgjidhnin të njëjtën degë. Mesatarisht, nga viti 2018 në vitin 2021, 85% e të diplomuarve të gjinisë mashkullore dhe 79% e të diplomuarave të gjinisë femërore do të përzgjidhnin të njëjtën degë.


Figura 30: Përzgjedhja e së njëjtës degë studimi (2018-2022)



**Shënim:** Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza M:** 2018 (N=69); 2019 (N=83); 2020 (N=57); 2021 (N=29); 2022 (N=62); **Baza F:** 2018 (N=45); 2019 (N=97); 2020 (N=95); 2021 (N=51); 2022 (N=87)

Ndërkohë, përzgjedhja e së njëjtës shkollë e disagreguar sipas gjinisë jepet në figurën 31. Për vitin 2022, 89% e të diplomuarve të gjinisë mashkullore dhe 84% e të diplomuarave të gjinisë femërore do të përzgjidhnin të njëjtën shkollë. Mesatarisht, nga viti 2018 në vitin 2021, 83% e të diplomuarve të gjinisë mashkullore dhe 80% e të diplomuarave të gjinisë femërore do të përzgjidhnin të njëjtën shkollë.

Figura 31: Përzgjedhja e së njëjtës shkollë (2018-2022)



**Shënim:** Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza M:** 2018 (N=69); 2019 (N=83); 2020 (N=57); 2021 (N=29); 2022 (N=62); **Baza F:** 2018 (N=45); 2019 (N=97); 2020 (N=95); 2021 (N=51); 2022 (N=87)

### 3.12 Planet për të ardhmen

Të pyetur për planet që kanë të diplomuarit për të ardhmen e tyre të afërt në aspektin profesional dhe të kualifikimit të mëtjshëm (shiko tabelën 14), 46% e të diplomuarve në vitin 2022 shpresojnë të kenë gjetur një punë që lidhet me fushën e tyre të studimit. Këtu, vërehet një ulje me 5 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2018-2021 (51%). Ndërkohë, 44% kanë pohuar se kanë dëshirë të kenë filluar biznesin e tyre. Aspiratat për sipërmarrje në këtë vit kanë shënuar nivelin më të lartë ndër vite (mesatarja 2018-2021 ka qenë 29%). Si rezultat, vërehet një rritje e aspiratave për sipërmarrje me 15 pikë përqindje.

Për më tepër, 36% e të diplomuarve në vitin 2022 pohojnë se kanë dëshirë të ndjekin studime të mëtjshme. Këtu, vërehet një ulje me 11 pikë përqindje në raport me mesataren e viteve 2018-2021 (25%). Nga ana tjetër, 11% e të diplomuarve kanë dëshirë të kenë emigruar jashtë vendit në dy vitet e ardhshme. Kjo kategori ka pësuar një ulje me 13 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2018-2021 (24%). Dëshira për migrim të brendshëm vijon të mbetet e ulët (1%).

Tabela 14: Planet e të diplomuarve për dy vitet e ardhshme (2018-2022)

	Të diplomuar në 2018	Të diplomuar në 2019	Të diplomuar në 2020	Të diplomuar në 2021	Të diplomuar në 2022
Të jem punësuar	21%	13%	7%	10%	15%
Të kem gjetur një punë që të lidhet me fushën time të studimit	53%	52%	50%	48%	46%
Të kem filluar biznesin tim	20%	23%	39%	33%	44%
Të kem ndjekur studime të mëtjshme	11%	36%	26%	26%	36%
Të kem emigruar jashtë vendit	25%	22%	24%	24%	11%
Të kem migruar në një qytet tjetër brenda vendit	1%	0%	1%	0%	1%
Tjetër	2%	3%	4%	6%	3%

Shënim: Kjo është pyetje me përgjigje të shumëfishta. Shuma e përqindjeve nuk është e barabartë me 100%. Baza: 2018 (N=114); 2019 (N=180); 2020 (N=152); 2021 (N=80); 2022 (N=149)

## 4 Përfundime

Në këtë raport paraqiten rezultatet kryesore nga gjurmimi i të diplomuarve të Shkollës Teknike Ekonomike duke filluar me brezin e nxënësve të diplomuar në vitin 2018.

**Disa nga gjetjet kryesore të gjurmimit për të diplomuarit e 2022 janë përmbledhur më poshtë:**

- 71% e të diplomuarve të 2022 u gjurmuan një vit pas diplomimit.
- Nga një total prej 149 të anketuarish, 60% e tyre ishin në marrëdhënie pune (punësim/vetëpunësim), 15% pa punë, 24% ishin student/kursant. Për të pestë brezat e gjurmuar, numri i të diplomuarve që janë student/kursant është më i madh sesa numri i atyre që janë pa punë.
- 61% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes dhe 54% e të diplomuarve në Tekstil-Konfeksione ishin të punësuar një vit pas diplomimit. Përkatësisht, 15% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes dhe 23% e të diplomuarve në Tekstil-Konfeksione ishin pa punë. Për më tepër, 24% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes dhe 23% e të diplomuarve në Tekstil-Konfeksione ishin student/kursant.

- 66% e të diplomuarve në 2022 pohojnë se puna që ata bëjnë lidhet me studimet e tyre. Përqindja e të diplomuarve që janë shprehur se i përdorin njohuritë në vendin e punës “shumë/jashtëzakonisht shumë” për vitin 2022 është 30%. Vërehet një rritje me 2 pikë përqindje në karhasim me vitin 2021. Një vlerësim krahasues me vitet e kaluara pasqyron një përmirësim të nivelit të pagave të të diplomuarve.
- Sipas të dhënave të disagreguara sipas drejtimeve vëmë re se 4% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes dhe 14% e të diplomuarve në Tekstil-Konfeksione paguhen më pak sesa paga minimale. Ndërkohë, 10% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes dhe 29% e të diplomuarve në Tekstil-Konfeksione paguhen deri në 35,000 lekë. Për më tepër, 47% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes dhe 14% e të diplomuarve në Tekstil-Konfeksione paguhen mes 35,001 dhe 50,000 lekë. Gjithashtu, 14% e të diplomuarve në të dy drejtimet paguhen 50,001 - 65,000 lekë. Ndërkohë, 12% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes paguhen 65,001 – 80,000 lekë. Për më tepër, 13% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes dhe 29% e të diplomuarve në Tekstil-Konfeksione paguhen më shumë se 80,001 lekë.
- 56% e të diplomuarve janë punësuar para se të diplomohen, kjo shënon një rënie në raport me mesataren 2018-2021 ku 61% e të diplomuarve gjenin një punë para se të diplomoheshin. Ndërkohë, 13% janë punësuar një muaj pas diplomimit, 8% deri në tre muaj pas diplomimit dhe 7% nëntë deri në dymbëdhjetë muaj pas diplomimit.
- Të diplomuarit përgjithësisht ndihen të sigurt dhe të kënaqur në punën e tyre aktuale, ku rreth 71% e tyre janë përgjigjur “të sigurt/shumë të sigurt” dhe 66% “të kënaqur ose shumë të kënaqur”. Vërehet një korrelacion pozitiv mes sigurisë dhe kënaqësisë në vendin e punës.
- Niveli i të diplomuarve të papunë një vit pas diplomimit është 15%. Në numër absolut kjo shkon në 23 të papunë. Të pyetur nëse po kërkojnë për një mundësi punësimi, 13 prej tyre (57%) janë përgjigjur po.
- Sipas rezultateve të të diplomuarve në vitin 2022, të gjurmuarit vlerësojnë se çdo aspekt i shkollës ka nevojë për përmirësim “shumë/jashtëzakonisht shumë”. Përkatësisht, praktika në biznes (66%), bashkëpunimi me zyrat e punësimit (65%), praktika në shkollë (64%), bashkëpunimi me bizneset (61%) dhe këshillimi i karrierës (60%) vlerësohen se kanë më shumë nevojë për përmirësim.
- Brenda dy viteve të ardhshme 46% e të diplomuarve në vitin 2022 planifikojnë të kenë gjetur një punë që lidhet me fushën e tyre të studimit, 36% të ndjekin studime të mëtejshme dhe 11% të kenë emigruar jashtë vendit.
- Aspiratat për sipërmarrje në 2022 ka shkuar në nivelin 44% duke shënuar nivelin më të lartë ndër vite.